

Dr. Hajredin Hoxha

PROCESI I VETËVENDOSJES SË NACIONALITETIT SHQIPTAR GJATË REVOLUCIONIT DHE NDËRTIMIT SOCIALIST

1. Trajtimi teorik i çështjes së vetëvendosjes së pakicave nacionale

Dihet mirëfilli se, sipas marksizmit e leninizmit, parim fundamental i zgjidhjes së çështjes nacionale është parimi i vetëvendosjes së popujve. Në këtë pikëpamje, ndër teoricienët marksistë nuk ka dilema në planin teorik. Mirëpo, si ndër filozofët marksistë, ashtu edhe ndër të tjerët, ekziston dilema: a vlen parimi i vetëvendosjes për pakicat nacionale. Meqenëse nacionaliteti shqiptar në Jugosllavi hyn, në një mënyrë specifike, në radhët e pakicave nacionale përgjithësisht, e për të treguar se në të ka ekzistuar procesi i vetëvendosjes në revolucionin socialist, është e nevojshme që së pari të jipet përgjigjja në pyetjen: a vlen parimi i vetëvendosjes edhe për pakicat nacionale?

Sipas mendimit të teoricienëve borgjezë, parimi i vetëvendosjes nuk vlen për pakicat nacionale. Në këtë pikëpamje, Ilija Përzhqi thotë se parimi i vetëvendosjes nuk mund të zbatohet në pakicat nacionale për shumë arsye.¹ Filozofi amerikan Inis Klod »gjithashtu solidarizohet me qëndrimin e Lidhjes së Kombeve se parimi i vetëvendosjes nuk vlen për pakicat nacionale«.²

Ndër teoricienët marksistë ekzistojnë mendime divergjente: a vlen edhe për pakicat nacionale parimi i vetëvendosjes.

Është i njohur mendimi i Stalinit se parimi i vetëvendosjes vlen për kombe të tëra, kurse pakicat nacionale kanë të drejtë për ligj të veçantë, i cili u garanton barabarësi në kuadrin e shtetit.³

Koça Jonçiq, i cili i ka dhënë kontribut të rëndësishëm studimit të problemit të pakicave nacionale në Jugosllavi, konsideron gjithashtu se »pakicat nacionale nuk janë aso subjektsh që mund të ven-

¹ Ilija Përshiq, *Zaštita manjina*, Beograd 1933, faqe 19.

² Inis Klod, *Pakicat nacionale — problemet ndërkombëtare*, disertacion i doktoranturës, i mbrojtur në Universitetin e Kembrixhit në vitin 1955, faqe 12.

³ J. V. Stalin, *Marksizmi dhe çështja nacionale e koloniale*, Shkup 1948, faqe 78-79.

dosin për vetëvendosje gjer në shkëputje...⁴ Në këtë pikëpamje, Jonçiq e kritikon qëndrimin e Rezolutës së Kongresit IV të PKJ, me të cilin u njihet pakicave nacionale e drejta e vetëvendosjes dhe e drejta e unjësimit të popullit shqiptar të copëtuar.⁵ Mirëpo, në një vend tjetër Jonçiq flet se pakicat nacionale në Jugosllavi kanë vetëvendosur që të inkuadrohen në LNÇ të Jugosllavisë. Gjithashtu, kur flet për bashkimin e bregdetit sloven dhe kroat me Jugosllavinë, ai flet për vetëvendosjen e lirë të popullit të këtyre viseve për t'iu bashkuar Jugosllavisë.⁶ Duke folur për çështjen e Kosovës në perioidën e pasluftës, Jonçiq thotë se »shqiptarët e kësaj Krahine kanë shprehur qëndrim për të mbetur në Jugosllavinë Demokratike Federative«.⁷

Millan Marković konsideron se parimi i vetëvendosjes vlen për pakicat nacionale, por në një formë të modifikuar, me kusht që ai të mos mundet të zbatohet gjer në fund në pikëpamje të së drejtës për shkëputje.⁸ Teoricieni sloven Bodo Bordan është i mendimit se parimi i vetëvendosjes vlen për të gjitha kolektivitetet nacionale, e prandaj edhe për pakicën nacionale.⁹ Gjithashtu, Llaslo Rehak konsideron se parimi i vetëvendosjes vlen për pakicat nacionale dhe thotë se ky parim është sanksionuar në një mënyrë të caktuar edhe nga ana e Kombeve të Bashkuara me njohjen e së drejtës së vetëvendosjes së popujve përgjithësisht.¹⁰

Në shqyrtimin e çështjes: a vlen parimi i vetëvendosjes edhe për pjesët e kombeve, dmth. për pakicat nacionale, sipas mendimit tonë ka rëndësi qenësore të mbështetemi në Leninin dhe në qëndrimet e lëvizjes punëtore përgjithësisht, e posaçërisht në qëndrimet dhe në praktikën e PKJ në historinë e saj të gjertanishme.

Megjithëse Lenini nuk e ka shqyrtuar askund në mënyrë eksplicite çështjen: a vlen parimi i vetëvendosjes edhe për pakicat nacionale, jemi të mendimit se nga thelbi i teorisë së Leninit për çështjen nacionale dhe nga qëndrimet e tij të përgjithshme për çështjet e ndryshme konkrete të marrëdhënjeve në mes të kombeve mund të nxirret përfundimi se Lenini nënkupton plotësisht se parimi i vetëvendosjes vlen edhe për pjesët e kombeve, dmth. për pakicat nacionale.

Madje, në praktikën e Rusisë Sovjetike, kur ishte gjallë Lenini, hasim në shembuj të shumtë kur Lenini — në bazë të parimit të vetëvendosjes — është marrë konkretisht me zgjidhjen e problemeve të pjesëve të ndryshme të kombeve. Këtu duhet pasur parasysh se,

⁴ Koça Jonçiq, *Pravno-politički položaj i uloga narodnosti — nacionalnih manjina*, teza e doktoranturës, e mbrojtur në Fakultetin Juridik të Beogradit më vitin 1962, faqe 483-486.

⁵ *Ibid*, faqe 315.

⁶ *Ibid*, faqe 341 e 232.

⁷ *Ibid*, faqe 421.

⁸ Millan Marković, *Zaštita manjina u sklopu međunarodne zaštite*, R. P. Nr. 358, Biblioteka »Gjuro Gjaković«, Beograd, faqe 99-104.

⁹ Bodo Bordan, *Pravna zaštita narodnih manjina u Italiji*, disertacion i doktoranturës, i mbrojtur në Fakultetin Juridik të Lublanës më vitin 1965, faqe 128-129.

¹⁰ Llaslo Rehak, *Manjina u Jugoslaviji*, tezë e doktoranturës, e mbrojtur në Fakultetin Juridik të Novi Sadit, Beograd 1965, faqe 147.

në diskutime dhe në raste të ndryshme, Lenini ka përdorur për kolektivitetet nacionale termine të ndryshme, sikurse janë: kombi, populli, kombësia, nacionaliteti, pakica nacionale, grupi etnik etj. Megjithëse për Leninin terminet e përmendura nuk kanë domethënje të njëjtë, prapëseprapë — në diskutime rreth të gjitha këtyre termineve — ai është bazuar gjithnjë në parimin e vetëvendosjes së popujve.

Duke folur për pjesët e kombeve në Rusinë cariste dhe për veçantitë e tyre, Lenini ka kërkuar që të respektohet ndaj tyre parimi i vetëvendosjes, e në lidhje me këtë ka shkruar: »Veçantitë e këtij shteti janë: e para, se pjesëtarët e kombeve të tjera (të cilat, me përjashtim së bashku, përbëjnë shumicën e popullsisë) jetojnë pikërisht në krahinat periferike; e dyta, se shtypja e këtyre kombësive është shumë më e fortë se në shtetet fqinje (madje, jo vetëm evropjane); e treta, se në një sërë rastesh shtypja e këtyre kombësive, të cilat jetojnë në krahinat periferike dhe kanë bashkëkombas matanë të kufirit, të cilët gëzojnë pavarësi nacionale më të madhe (mjafton të përmenden, për shembull, buzë kufirit perëndimor finlandezët, suedezët, polonezët, ukrainasit, rumunët)... Më në fund, pikërisht në shtetet fqinje aziatike shohim se ka filluar etapa e revolucionit borgjez dhe e lëvizjeve nacionale, të cilat përfshijnë pjesërisht kombësitë e ngjashme brenda kufinjve të Rusisë... Në këtë mënyrë, veçantitë konkrete të çështjes nacionale në Rusi i japin ndër në një aktualitet të veçantë njohjes së të drejtës për vetëvendosje«.¹¹

Duke folur për këto kombësi, të cilat jashtë kufinjve të Rusisë kanë pjesë të tjera të kombit të tyre dhe të cilat i ka aneksuar Rusia cariste, Lenini thotë: »Në çështjen nacionale, partia proletare duhet të mbrojë, para së gjithash, proklamimin dhe realizimin e pashtyshëm të lirisë së plotë të shpëputjes nga Rusia të të gjitha atyre kombeve dhe kombësive, të cilat i ka shtypur carizmi, të cilat kanë qenë aneksuar me forcë ose janë mbajtur me forcë brenda kufinjve të shtetit, dmth. të cilat janë aneksuar«.¹²

Pikërisht kombësive të këtylla, të cilat kanë pjesë të tjera të popullit jashtë kufinjve, Lenini u ka bërë të mundur — duke u bazuar në parimin e vetëvendosjes — realizimin e formave të ndryshme të shtetësisë dhe të autonomisë në kuadrin e Rusisë Sovjetike. Kështu, gjer sa ende ishte gjallë Lenini, në bazë të instruksioneve dhe ideve të tij u formuan republikat:

1. Azerbejxhani (në Iran jetojnë 6,000.000 azerbejxhanas, kurse në BRSS jetojnë 3,900.000 pjesëtarë të kësaj kombësie).

2. Mongolia (megjithëse ka ekzistuar shteti mongolez jashtë kufinjve të Rusisë dhe pjesa e popullit mongolez në Kinë, e cila sot gëzon autonomi).

¹¹ V. I. Lenin, *Nacionalno i kolonijalno pitanje*, »Naprijed«, Zagreb, 1959, faqe 347.

¹² Hajredin Hoxha, *Geneza Autonomne Pokrajine Kosova i Metohije na osnovu principa samoopredeljenja naroda*, bot. në librin »Karakter i funksije Federacije«, Beograd 1968, faqe 134.

3. Turkestani (grup etnik i popullit turk).

4. Moldavia (pjesë e popullit rumun).

5. Karelo-Finlanda (shumicën e popullsisë e përbëjnë finlandezët, pjesë e kombit finlandez) etj.

Përveç kësaj, kur ishte gjallë Lenini, u formuan autonomia gjermane dhe ajo ebreje në kuadrin e Rusisë Sovjetike.

Qëndrimi afirmativ i Leninit ndaj njohjes së të drejtës së vetëvendosjes së pjesëve të kombeve, dmth. pakicave nacionale, është i qartë sidomos në diskutimet e tij lidhur me çështjen e aneksimëve. Lidhur me këtë ai thotë: »Të jesh kundër aneksimëve do të thotë të jesh për vetëvendosje... Protesti kundër aneksimëve nuk është asgjë tjetër veçse njohje e së drejtës së vetëvendosjes.«¹³ Duke i konkretizuar këto konceptione, Lenini ka shkruar: »Socialistët gjermanë, të cilët nuk kërkojnë liri të shkëputjes së kolonive: alzasasëve, danezëve, polonezëve... socialistët e këtyllë veprojnë si nacionalistë, si lakej.«¹⁴

Meqenëse pjesët e aneksuara kanë përfshirë kryesisht pakicat nacionale ose pjesë të konsiderueshme të kombeve të ndryshme, insistimi për vetëvendosje me rastin e zgjidhjes së problemit të aneksimëve do të thotë faktikisht njohje e së drejtës së vetëvendosjes së pjesëve të kombeve.

Jemi të mendimit se prej konceptioneve të përmendura të Leninit mund të nxiret përfundimi i qartë se ai nënkupton parimin e vetëvendosjes edhe të pjesëve të kombeve, dmth. pakicave nacionale dhe se në praktikën e tij revolucionare ka zbatuar parimin për të gjitha kolektivitetet nacionale, e prandaj edhe për pjesët e kombeve, dmth. për pakicat nacionale.

Një qëndrim të ngjashëm me atë të Leninit kanë pasur rreth çështjes së vetëvendosjes të gjitha partitë revolucionare të klasës punëtore, e prandaj edhe Partia socialdemokrate serbe dhe Partia komuniste e Jugosllavisë. Kështu, Partia socialdemokrate e Sërbisë ka kërkuar energjikisht që të zbatohet parimi i vetëvendosjes për pjesën e popullit serb në Bosnë e Hercegovinë »që kjo pjesë e popullit të realizojë të drejtë për vetëvendosje.«¹⁵

PKJ ka pasur një qëndrim të ngjashëm në lidhje me të drejtën e pakicave nacionale për vetëvendosje, gjë që shihet në mënyrë të qartë në Rezolutën e Kongresit të tretë dhe të katërt të Partisë. Mirëpo, ky qëndrim i PKJ është shprehur në mënyrë eksplicite në një deklaratë të PKJ, të PK të Italisë dhe të PK të Austrisë më vitin 1937. Pas aprovimit të qëndrimit në këtë dokument se parimi i vetëvendosjes duhet të realizohet edhe për pakicat nacionale, në deklaratën e përmendur thuhet: »1. Të triat votojnë dhe shprehen për vetëvendosje pa kushte të popullit slloven gjer në shkëputje prej shteteve imperialiste: Jugosllavisë, Italisë dhe Austrisë, të cilat sot e shtypin popullin slloven. Ato kërkojnë të drejtë të njëjtë për

¹³ V. I. Lenin, *ibid*, faqe 260.

¹⁴ *Ibid*, faqe 254.

¹⁵ Villado Strugar, *Socialdemokratija o nacionalnom pitanju jugoslovenskih naroda*, »Rad«, Beograd 1956, faqe 29.

vetëvendosje edhe për të gjitha pacikat e tjera nacionale (kroatët, gjermanët, italianët), që jetojnë në territorin e gjuhës sllovene».¹⁶

Dëshirojmë të vemë në dukje se edhe borgjezia austro-hungareze pas Luftës së parë botërore e sanksionoi parimin e vetëvendosjes së pakicës nacionale sllovene kur lejoi plebiscit në Korushkë, ku popullsia duhet të shprehej për bashkim me Jugosllavinë ose për të mbetur nën Austri.

Duke vlerësuar në mënyrë afirmative deklaratën e përmendur të tri partive, Eduard Kardeli insistoi — në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv të KQ të LK të Jugosllavisë më vitin 1958 — se bashkimi i popujve të copëtuar nuk mund të realizohet me anë të konflikteve të luftës për ndryshimin e kufinjve, por me luftën e të gjitha pjesëve të kombeve për progres dhe për bashkëpunim me popujt fqinj. Me këtë rast, Eduard Kardeli shprehi bindje se socializmi ka për të sjellë unjësimin e popujve të copëtuar me anë të zhdukjes së kufinjve.¹⁷

PKJ shprehi qëndrimin e vet afirmativ në lidhje me vetëvendosjen e pjesëve të kombeve dhe në Konferencën e vet të pestë, lidhur me çështjen e Bosnës dhe Hercegovinës, kur u tha se do të krijohen kushte ku popujt e Bosnës dhe Hercegovinës »do të vendosin lirisht vetë dhe do të gjejnë zgjidhje për rregullim në këto regjione«.¹⁸ Është i ngjashëm qëndrimi i PKJ lidhur me çështjen e vetëvendosjes së pjesëve të kombeve edhe ndaj Kosovës dhe kombeve shqiptare në Jugosllavi gjatë gjithë periudës së revolucionit socialist.

Duke sendërtuar konceptin e përgjithshëm lidhur me të drejtën e pakicave nacionale për vetëvendosje, Svetozar Vukmanović, në një letër dërguar shokut Tito, ka shkruar: »Komunistët maqedonë kanë qëndrim se duhet të njihet e drejta e vetëvendosjes së pakicave nacionale maqedone në Greqi... PK e Greqisë ka qëndrim të vet, sipas të cilit pakica nacionale maqedone duhet të sigurojë të drejta në kuadrin e Greqisë, por nuk e njeh të drejtën e vetëvendosjes së popujve. Pas një polemike të gjatë, ata pranuan që, pas çlirimit, popujt e Ballkanit t'i rregullojnë marrëdhënjet në bazë të parimit të vetëvendosjes«.¹⁹

Duke e informuar Georgi Dimitrovin për marrëdhënjet që ishin krijuar në mes të Greqisë dhe komunistëve maqedonë në lidhje me vetëvendosjen e maqedonëve në Greqi, si dhe se pranë Komitetit Qendror të PKJ është mbajtur një mbledhje me përfaqësuesit e komunistëve grekë dhe atyre maqedonë, Josip Broz shkruan: »Unë kam fituar përshtypje se shokët grekë kanë me të vërtetë qëndrim të gabueshëm rreth çështjes së maqedonëve në Greqi dhe jam përpjekë që ta korrigjoj këtë pa i bërë ndonjë dëm lëvizjes çlirimtare greke«.²⁰

¹⁶ Tito i *revolucija*, botim »Kultura«, Beograd, 1967, faqe 19.

¹⁷ Shënimet stenografike nga mbledhja e Komitetit Ekzekutiv të KQ të LKJ më vitin 1958, dokumenti nr. 78.

¹⁸ Koça Jonçiq, *ibid*, faqe 318.

¹⁹ Letra e Svetozar Vukmanoviçit dërguar shokut Tito, dok. nr. 19-20, V 1-42, *Lëvizja ndërkombëtare punëtore*, Beograd.

²⁰ Letra e J. B. Titos dërguar Georgi Dimitrovit më vitin 1944, dokumenti nr. 21697, *Lëvizja Ndërkombëtare punëtore*, Beograd.

Nën ndikimin e qëndrimit internacionalist të Georgi Dimitrovit, pas Luftës së dytë botërore KQ i PK të Bullgarisë dhe qeveria e Bullgarisë Demokratike e njohtën të drejtën e vetëvendosjes së pakicës nacionale maqedone në Maqedoninë Pirine dhe shprehën gadishmëri që ta përkrahin unjësimin e kësaj pakice me RP të Maqedonisë.²¹

Po, sipas mendimit tonë, dilemën se a kanë të drejtë për vetëvendosje pakicat nacionale e ka hequr prej rendit të ditës — të paktën në Jugosllavi — Mbledhja e dytë e AVNOJ-it me vendimin që »pakicave nacionale u janë njohur të gjitha të drejtat nacionale«. ²² Llaslo Rehak thekson me të drejtë se shprehja »të gjitha të drejtat« përfshinë para së gjithash të drejtën e vetëvendosjes së pakicave nacionale.²³

Prej konstatimeve të përmendura mund të përfundohet se parimi i vetëvendosjes së popujve vlen, në pikëpamje qenësore, edhe për të gjitha kolektivitetet nacionale, e prandaj edhe për pakicat nacionale.

Dëshirojmë të theksojmë se protagonistët e mohimit të së drejtës për vetëvendosje të pakicave nacionale në një anë e trajtojnë këtë çështje në mënyrë të njëanshme, formale, rigorozisht juridike-mekanike kurse, në anën tjetër konceptin e pakicave nacionale e trajtojnë në mënyrë abstrakte, jashtë rrethanave konkrete shoqërore-historike dhe territoriale-politike. Për këtë arsye, është e nevojshme të caktohen në mënyrë pak më konkrete konceptet e vetëvendosjes dhe të pakicave nacionale.

2. Thelbi i parimit të vetëvendosjes

Sipas mendimit tonë, koncepti i parimit të vetëvendosjes së kombeve është shumë i ndërlikuar dhe subtil; ai përmban në vetëvete komponenta dhe premisa të shumta — si për nga përmbajtja e tij, ashtu edhe për nga modifikimet dhe mundësitë e realizimit të këtij parimi. Do të përpiqemi t'i parashtrojmë këtu premisat qenësore të konceptit të parimit të vetëvendosjes, të cilat — sipas mendimit tonë — janë këto:

1. Premisa substanciale dhe më e gjerë e konceptit të vetëvendosjes në domethënjën e tij filozofiko-sociologjike është e lidhur me konceptin e lirisë së individëve dhe të kolektivitetëve të tëra nacionale që vetë ta caktojnë drejtimin e tyre të jetës, ta caktojnë pavarësisht, në rrethana të caktuara objektivë, ardhmërinë e tyre në pikëpamje të vetëinstitivës, vetërealizimit dhe vetëqeverisjes. Ky

²¹ Letra e Komitetit Qendror të Partisë Punëtore të Bullgarisë, dërguar Josip Broz Titos më 2 nëndor të vitit 1944, ku shprehet për formimin e shtetit maqedon dhe për bashkimin e popullit maqedon, *Zbornik statija, govori i dokumenti*, »Kultura«, Shkup 1970, faqe 37 e 39.

²² *Drugo zasjedanje Antifašističkog veća narodnog oslobođenja 1943. godine*, »Kultura« 1953, Beograd, faqe 21.

²³ Llaslo Rehak, ibid, faqe 147 dhe diskutimi në Simposium për karakterin e Federatës, mbajtur në Beograd më vitin 1968.

atribut kërkon fuqi të vetëdijshme të nacionalitetit, e cila si subjekt, si kreative dhe realizatore e kolektivitetit nacional, angazhohet për qëllime të caktuara dhe ndërmerr aksione dhe masa të caktuara për realizimin e këtyre qëllimeve.

Kjo komponentë e vetëvendosjes vlen për të gjitha kolektivitetet nacionale dhe për të gjitha periodat e ekzistimit të tyre. Mirëpo, cili drejtim do të dominojë në orientimin e nacionalitetit të caktuar në procesin e vetëvendosjes së tij, për çka do të angazhohet e kundër ç'gjëje do të luftojë — kjo varet prej marrëdhënjeve klasore të brendshme në nacionalitetin e caktuar, varet prej asaj se cila klasë shoqërore është hogjemone e lëvizjes nacionale prej asaj se për cilin sistem shoqëror ka qenë fjala ose çfarë është forma e socializmit i cili ndërtohet.

2. Përmbajtja e dytë, më e ngushtë, e konceptit të vetëvendosjes shprehet në të drejtën për vetëvendosje. Me anë të lëvizjes nacionale dhe revolucionit borgjez ose socialist, kolektivitetet nacionale — nën udhëheqjen e klasës së caktuar — duke realizuar vetëvendosjen realizojnë të drejtën për vetëvendosje, dmth. shtetësinë, dmth. pavarësinë, dmth. sovranitetin politik të kolektivitetit nacional. Duke folur për solucionet konkrete të realizimit të së drejtës për vetëvendosje, Lenini ka theksuar këto: »a) Përjashtimi i dhunës në çfarëdo forme nga ana e kombeve dominuese ndaj atij kombi, i cili dëshiron të shkëputet. b) Zgjidhja e kësaj shkëputjeje ekskluzivisht në bazë të së drejtës së përgjithshme, të drejtëpërdrejtë, të barabartë dhe të përhershme të votës. c) Lufta kundër shtypjes nacionale ose mohimit të së drejtës për vetëvendosje.«²⁴

E drejta për vetëvendosje paraqitet këtu si mundësi e caktimit të formës së shtetësisë ose si mundësi e orientimit nga shteti i pavarur ose nga shteti federativ, bashkë me popujt e tjerë. Prandaj, e drejta e vetëvendosjes përfshin në vetëvete edhe të drejtën e njësisimit — gjë që shpeshherë nuk përfillet kur shqyrtohen çështjet e pakicave nacionale — si dhe të drejtën e shkëputjes dhe të formimit të shtetit të pavarur, respektivisht bashkimit me kombin amë.

3. Përmbajtje edhe më e ngushtë e parimit të vetëvendosjes në krahasim me të drejtën e vetëvendosjes është e drejta e shkëputjes. Megjithëse e drejta e shkëputjes, e cila përfshin në vetëvete edhe të drejtën e njësisimit, është shprehje e totalitetit të së drejtës së vetëvendosjes, kjo e drejtë realizohet me anë të orientimit dhe vendimit afatshkurtër, respektivisht me anë të aktit të shkëputjes ose të njësisimit, vendim të cilin kolektiviteti nacional mund ta marrë kurdo që është në interes të tij nacional. Pra, e drejta për vetëvendosjen është një mundësi me afat të gjatë e kolektivitetit nacional, kurse e drejta e shkëputjes ose njësisimit realizohet me anë të aktit afatshkurtër të rregullimit të marrëdhënjeve ndërnacionale dhe të shteteve.

Jemi të mendimit se dukuritë e trajtimit të njanshëm të thelbit të parimit të vetëvendosjes janë më të shumta atëherë, kur e drejt-

²⁴ V. I. Lenin, *ibid*, faqe 72.

ta e vetëvendosjes identifikohet me të drejtën e shkëputjes, e jo njëkohësisht edhe me të drejtën e mbetjes në bashkësinë multinationale ose me të drejtën e bashkimit me ndonjë bashkësi tjetër multinationale.

Sipas mendimit tonë, Lenini insiston për të drejtën e shkëputjes jo për shkak se ky është ideal i tij, por me qëllim që me — garantimin e kësaj të drejte — të krijojë vetëbesim, siguri të kolektiviteve nacionale ndaj ardhmërisë së tyre, me qëllim që në këtë mënyrë të krijohet klima për unjësimin e tyre me popujt e tjerë. Kjo do të thotë se ideal i Leninit është unjësimi, e jo ndarja e kolektiviteve nacionale. Në këtë pikëpamje, Lenini thotë: »Ne kemi nevojë për liri të vetëvendosjes, dmth. për liri të shkëputjes së kombeve të shtypura — jo për të imagjinuar grimcimin ekonomik ose idealin e shteteve të vogla, por — përkundrazi — për shkak se duam shtete të mëdha dhe afrim, madje edhe asimilim të kombeve, por në një bazë me të vërtetë demokratike, me të vërtetë internacionaliste, e cila as nuk mund të merret me mend pa liri për vetëvendosje«. ²⁵

4. Koncepti më i ngushtë dhe trajtimi konkret i parimit të vetëvendosjes është vetë akti i shkëputjes. Në të vërtetë, duhet dalluar konceptin e së drejtës për shkëputje nga vetë akti i shkëputjes, dmth. nga realizimi i kësaj të drejte në praktikë. Dëshirojmë të theksojmë se dilemat më të shumta në interpretimin dogmatiko-etatist të parimit të vetëvendosjes përgjithësisht, e të pakicave nacionale posaçërisht, rezultojnë pikërisht nga kuptimi i gabueshëm, respektivisht nga moskuptimi i ndryshimit në mes të së drejtës për shkëputje dhe vetë aktit të shkëputjes. Këto pikëpamje nuk e kuptojnë dialektikën marksiste të relacionit të së drejtës për shkëputje dhe aktit të shkëputjes.

Duke paraqitur këtë dialektikë të relacionit të përmendur, Lenini thotë: »Ne jemi për autonomi për të gjitha pjesët e shtetit, ne jemi për të drejtë të shkëputjes... Shkëputja nuk është aspak plan i ynë, ne nuk e predikojmë kurrë shkëputjen. Marrë në përgjithësi, ne jemi kundër shkëputjes. Ne jemi për të drejtë të shkëputjes«. ²⁶ Më tutje: »Njohja e së drejtës së të gjitha nacionaliteteve për vetëvendosje nga ana e socialdemokracisë nuk do të thotë kurrësesi se socialdemokratët heqin dorë nga vlerësimi i oportunitetit të shkëputjes së këtij apo atij kombi në çdo rast veç e veç. Përkundrazi, socialdemokratët duhet të kenë patjetër pikërisht vlerësim të pavarur, duke përfillur dhe duke u bazuar në radhë të parë dhe para së gjithash në interesat e luftës klasore të proletariatit për socializëm«. ²⁷

Prej citateve të përmendura shihet se Lenini nuk e identifikon të drejtën për shkëputje me aktin e shkëputjes dhe se njohja e së drejtës për shkëputje nuk do të thotë edhe angazhim në çdo rast për akt të shkëputjes, por njohja e kësaj të drejte, në thelb, duhet të krijojë kushte që të mos bëhet shkëputja. Mirëpo, a do të anga-

²⁵ *Ibid.* faqe 83.

²⁶ *Ibid.*

²⁷ *Ibid.*, faqe 72

zhohen konkretisht klasa punëtore dhe partia e saj për aktin e shkëputjes në një rast apo në një tjetër — kjo, sipas mendimit të Leninit, varet nga vlerësimi se një shkëputje e tillë a është në të mirë apo u sjell dëm interesave të klasës punëtore dhe të socializmit.

Duke u angazhuar në thelb kundër realizimit të aktit të shkëputjes, Lenini e ka shprehur taktikën e veprimit të klasës punëtore në kombin dominues, i cili duhet të insistojë për shkëputjen e kombit të shtypur dhe të klasës punëtore të kombit të robëruar i cili — pasi ta fitojë të drejtën për vetëvendosje dhe shkëputje — duhet të angazhohet në kuadrin e kombit të vet që të mos bëhet shkëputja faktike. Duke e konkretizuar këtë taktikë, Lenini ka shkruar: »Sikur punëtorët suedezë të mos ishin pa kushte për liri të shkëputjes së norvegjezëve, ata do të ishin shovenistë, e sikur punëtorët norvegjezë të mos e parashtronin me kusht çështjen e shkëputjes, po të mos i bënin rezistencë shkëputjes, e cila do të bëhej nën udhëheqjen e borgjezisë dhe në interes të saj, ata nuk do të ishin internacionalistë, por nacionalistë«.²⁸

Po, qëndrimi sipas të cilit çështja e aktit të shkëputjes së kolektiviteteve nacionale duhet të trajtohet nga prizma e luftës klasore së proletariatit, është konkretizuar prej Marksit në çështjen e Irlandës. Kështu, në një periudë Marks i ka qenë kundër shkëputjes së Irlandës prej Anglisë. Mirëpo, në rrethana të tjera historike ai është angazhuar energjikisht për shkëputjen e Irlandës prej Anglisë, duke theksuar se »interesat e drejtëpërdrejta të klasës punëtore angleze kërkojnë që të ndërpritet lidhja e gjertanishme me Irlandë«.²⁹

PKJ e ka trajtuar, në thelb, në mënyrë marksiste-leniniste çështjen e oportunitetit konkret të angazhimit për aktin e shkëputjes ose të përpjekjeve për pengimin e këtij akti. Në lidhje me këtë, në Konferencën e tretë të PKJ thuhet: »Çështja e oportunitetit dhe mosoportunitetit të shkëputjes do të zgjidhet në çdo situatë konkrete historike pavarësisht, nga aspekti i interesave të progresit dhe të luftës klasore të proletariatit«. Në Rezolutë theksohet qëndrimi se »sa më e plotë është vetëvendosja, aq më shumë do dobësohet separatizmi«.³⁰

Një qëndrim të ngjashëm lidhur me oportunitetin e shkëputjes e shpreh edhe Eduard Kardeli në librin e tij »Slovenačko nacionalno pitanje«. Në lidhje me këtë ai thotë: »E drejta për shkëputje ende nuk do të thotë edhe detyrë e shkëputjes. Vendimi varet prej faktit se në çfarë relacioni janë në rastin përkatës forcat e përparimit dhe ato të reaksionit në situatën politike ndërkombëtare«.³¹

Duke vepruar në frymën e këtyre qëndrimeve, PKJ ka marrë në momente të ndryshme qëndrime të ndryshme në lidhje me oportunitetin e shkëputjes së popujve dhe kombësive të Jugosllavisë

²⁸ *Ibid*, faqe 72 dhe 311-312.

²⁹ Karl Marks e Fridrih Engels, *Korespondenca*, vëll. III, faqe 494.

³⁰ Arkivi historik i PKJ, I, II, *Kongresi i zemaljske konferencije 1919-1937*, faqe 70.

³¹ Eduard Kardel, *Razvoj slovenačkog nacionalnog pitanja*, Beograd, 1960, faqe 311-312.

në perioda të ndryshme kohe. Dihet se në Kongresin e saj të katërt PKJ mori qëndrim dhe u angazhua për shkëputjen e popujve dhe të pakicave nacionale të Jugosllavisë. Duke mos u thelluar me këtë rast në analizën e këtij qëndrimi, dëshirojmë të vemë në dukje faktin se ky qëndrim ka ndryshuar në veprimtarinë e mëtejshme të Partisë — më së shumti nën ndikimin e paraqitjes së rrezikut fashistë. Kështu, në Rezolutën e Moskës të vitit 1936, në lidhje me këtë thuhet: »Duke mos hequr dorë nga parimi i së drejtës për vetëvendosje gjer në shkëputje, PKJ vepron kundër copëtimit të territorit të sotshëm të Jugosllavisë, meqenëse do që ta arrijë riorganizimin e shtetit në mënyrë paqësore, në bazë të barabarësisë nacionale«.³²

Në frymën e këtij qëndrimi, në Plenum të Komitetit Qendror, mbajtur në Split në vitin 1936, u aprovua orientimi që të realizohet e drejta e vetëvendosjes me anë të formimit të bashkësisë federative të popujve të barabartë.

Prandaj, është fare e qartë se e drejta e shkëputjes dhe akti i shkëputjes janë dy përmbajtje të ndryshme, e se e drejta e shkëputjes nuk do të thotë njëkohësisht edhe realizim i saj, as detyrë që ajo të realizohet në çdo rast. Nevoja e shndërrimit të së drejtës së shkëputjes në akt konkret të shkëputjes dhe qëndrimi që të merren masa konkrete për realizimin e këtij akti varen nga vlerësimi: a i ndihmon akti i këtillë progresit, luftës klasore të proletariatit për socializëm, a i ndihmon realizimit të barabarësisë nacionale dhe afrimit të popujve.

Nga tërë parashtrimi lidhur me vetëvendosjen del përfundimi se parimi i vetëvendosjes është kategori shumë delikate filozofiko-sociologjike, se është proces shoqëror shumë subtil në jetën e kombeve dhe se, për këtë arsye, përmban më vetëvete premisa, specifika dhe solucione të shumta të sendërtimit në jetën e të gjitha kolektiviteteve nacionale, e edhe të pakicave nacionale.

3. Tipet e pakicave nacionale dhe parimi i vetëvendosjes

Për ta përballuar dilemën: a vlen parimi i vetëvendosjes për pacikat nacionale dhe për ta vënë në dukje kompleksin e specifikave dhe numrin e madh të modaliteteve të realizimit të parimit të vetëvendosjes për llojet e ndryshme të kolektiviteteve nacionale dhe për pacikat e ndryshme nacionale, kemi bërë një tipizim të pakicave nacionale në botën bashkëkohore. Sipas mendimit tonë, të gjitha pacikat nacionale mund të përfshihen kryesisht në katër tipe:

Tipi i parë kishte për të përfshirë ato pjesë të kombeve të ndryshme, që janë të ndara territorialisht nga ama e tyre dhe përbëjnë pakicën e popullsisë në teritorin përkatës, si për shembull turqit në Maqedoni, çekët në Vojvodinë, hungarezët në Slloveni, rusinët në Bosnë e Hercegovinë etj. Sa u përket këtyre pakicave vlen domethënja sociologjiko-filozofike e parimit të vetëvendosjes, vlen e drejta e vetëvendosjes në pikëpamje të realizimit të së drejtës së plotë për afirmim të pavarur nacional, për shprehje të plo-

³² Si shën. 30, faqe 163.

të nacionale dhe për mundësinë e ruajtjes së individualitetit të vet nacional. Mirëpo, në këto pakica nacionale nuk mund të shprehet edhe e drejta për shkëputje — me përjashtim të së drejtës së pjesëtarëve të këtyre pakicave nacionale që të shpërngulen vullnetarisht në vendet amë.

Tipi i dytë përfshin ato pjesë të kombeve të ndryshme, të cilat gjithashtu janë të ndara prej amave të tyre në pikëpamje territoriale, por në territoret e caktuara e përbëjnë shumicën e popullsisë, sikurse ka ndodhur me gjermanët ose ebrejtë në Rusinë cariste. Këto pakica nacionale — krahas me shfrytëzimin e parimit të përgjithshëm të vetëvendosjes, sikurse edhe tipi i mëparshëm, mund ta realizojnë edhe të drejtën e vetëvendosjes në pikëpamje të vet-organizimit dhe të formimit të formave të ndryshme të autonomisë, sikurse janë: krahina autonome, provinca autonome dhe qarku nacional, gjë që edhe ka qenë realizuar në Rusinë Sovjetike pas Revolucionit të Tetorit. Mirëpo, as ky tip i pakicave nacionale nuk mund ta realizojë të drejtën e shkëputjes, meqenëse territorialisht nuk është në kontakt me kombin amë. Ai mund ta realizojë këtë të drejtë gjithashtu me anë të shpërnguljes vullnetare.

Tipi i tretë përfshin ato pjesë të kombeve të ndryshme, të cilat territorialisht puqen me kombin amë, por të cilat në regjionet kufitare të vendit amë përbëjnë pakicën e popullsisë. Këto pakica nacionale mund ta realizojnë parimin e vetëvendosjes sikurse edhe dy tipet e mëparshme dhe të drejtën e vetëvendosjes në pikëpamje të afirmimit autonom nacional, por poashtu nuk mund ta realizojnë të drejtën e shkëputjes, sepse — sipas solucioneve të Leninit — një ndër mundësitë e realizimit të kësaj të drejte është plebisciti i popullsisë. Meqenëse kjo pakicë përbën pakicën e popullsisë në regjionet kufitare, faktisht është ireale të supozohet mundësia e realizimit të parimit të vetëvendosjes. Pakica të këtilla nacionale janë, për shembull, italianët në Kroaci, rumunët në Vojvodinë etj.

Tipin e katërt, të fundit, të pakicave nacionale e përbëjnë ato pjesë relativisht të mëdha të kombeve të ndryshme, të cilat në pikëpamje territoriale puqen në një vijë të gjatë me kombet amë dhe të cilat në një territor relativisht të madh, që edhe ashtu është tërësi ekonomiko-gjeografike, përbëjnë shumicën absolute të popullsisë. Pakica nacionale të këtilla janë, për shembull, ajo shqiptare dhe bullgare në Jugosllavi, pakica hungareze në Rumuni e Çekoslllovakia, maqedone në Bullgari, sllovene në Austri dhe Itali, kurdët në Turqi ose në Irak dhe kombësitë e shumta në kuadrin e BRSS, për të cilat folëm më parë. Për pakicat nacionale të këtilla, parimi i vetëvendosjes në thelbin e tij vlen në totalitetin e tij dhe në të gjitha premiset e tij, kështu që vlen edhe e drejta e shkëputjes.

Nga aspekti i ekzistimit të disa tipeve të pakicave nacionale mund të pranohet mendimi i Millan Markoviçit se parimi i vetëvendosjes — në disa modalitete të tij — nuk mund të realizohet në të gjitha nyencat e veta në kushtet e pakicave të ndryshme nacionale. Mirëpo, për nacionalitetin shqiptar, i cili përbën 70% të shqiptarëve në krahasim me ata në Shqipëri dhe i cili përbën afër

1,350.000 qytetarë në Jugosllavi dhe është në shumicë absolute në Krahinën e Kosovës dhe në pesë komuna jashtë Krahinës së Kosovës — parimi i vetëvendosjes vlen në totalitetin e tij të plotë.

Për këtë arsye, në vazhdim të parashtrimit do të bazohemi në këtë parim dhe do të tregojmë se si është afirmuar dhe realizuar në proceset e gjertanishme gjatë revolucionit socialist dhe ndërtimit të pasluftës.

4. Procesi i vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi dhe qëndrimet e PKJ

Në tërë zhvillimin e lëvizjes nacionale të nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi — si gjatë revolucionit socialist, ashtu edhe në ndërtimin e pasluftës — është zhvilluar procesi i vetëvendosjes dhe lufta për realizimin e së drejtës së vetëvendosjes së këtij nacionaliteti, me përkrahje të plotë të fuqive progresive të popujve të tjerë të Ballkanit dhe me ndihmën e partive të tyre komuniste dhe punëtore.

Duke u angazhuar për të drejtën e vetëvendosjes së të gjithë popujve të Ballkanit, e prandaj edhe të popullit shqiptar, dhe duke gjykuar copëtimin e popullit shqiptar në Konferencën e Londrës të vitit 1913, Vlladimir Iliç Lenin i dha përkrahje lëvizjes nacionale të shqiptarëve për unjësime dhe luftës së tij kundër mbretërisë së Sërbisë dhe Jugosllavisë borgjeze në territoret e Jugosllavisë së sotshme.³³

Edhe Partia Socialdemokrate Sërbe mori qëndrim të ngjashëm ndaj të drejtës së nacionalitetit shqiptar për vetëvendosje dhe kundër copëtimin të popullit shqiptar. Kështu, Dimitrije Tucoviç — duke kundërshtuar aneksimin e Kosovës nga ana e Sërbisë më vitin 1912 dhe duke i dhënë mbrojtje të drejtës për vetëvendosje të nacionalitetit shqiptar — tha në emër të Partisë së vet në Kongresin e Internacionales së Dytë në Amsterdam: »Lufta principiele e socialdemokracisë kundër politikës pushtuese, për të drejtën e vetëvendosjes nacionale, është kusht për jetën e lëvizjes punëtore dhe të socialdemokracisë në popujt e vegjël të shtypur«.³⁴

Që nga formimi i saj, PKJ ka pasur qëndrim leninist ndaj çështjes së vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi. Në Konferencën e saj të tretë, PKJ dënoi politikën pushtuese të borgjezisë sërbe, e cila ndiqte »politikë pushtuese dhe koloniale në Maqedoni dhe kundër Shqipërisë«. Me atë rast, PKJ theksoi kërkesën që »t'i njihet çdo populli e drejta e sovranitetit në caktrimin e marrëdhënjeve të veta, e prandaj edhe e drejta e shkëputjes së lirë dhe formimit të shteteve të tyre, respektivisht bashkimit me shtetet e tyre amë«, kurse ky qëndrim ka pasur të bëjë edhe me nacionalitetin shqiptar në Jugosllavi.³⁵

³³ V. I. Lenin, *ibid*, faqe 47 dhe Arkivi qendror/historik i Republikës Popullore të Shqipërisë, dok. nr. B. C. D.

³⁴ Vllado Strugar, *ibid*, faqe 93 dhe Dimitrije Tucoviç, *ibid*, faqe 24.

³⁵ Si shën. 30, faqe 69 e 70.

Në këtë vijë, Kongresi i katërt i PKJ theksoi në Rezolutën e vet solidaritetin »e punëtorëve revolucionarë dhe fshatarëve të kombeve të tjera të Jugosllavisë, e para së gjithash të Sërbisë, me lëvizjen nacionale-revolucionare shqiptare në qenjen e Komitetit Kosovar dhe e thërret klasën punëtore që ta ndihmojë gjithanësisht luftën e popullit shqiptar të copëtuar dhe të shtypur për një Shqipëri të pavarur dhe të unjësuar«.³⁶ Në Rezolutë dënohet rivaliteti i imperializmit italian dhe sërboomadh »në kurriz të popullit shqiptar, si në Shqipëri ashtu edhe në Jugosllavi. Populli shqiptar... mund të çlirohet dhe të unjësohet duke u mbështetur në punëtorët, në fshatarësinë dhe në lëvizjet e tjera të kombeve të shtypura të Ballkanit, në luftën masive nacionale-revolucionare — si kundër sërboomëdhënjeve, ashtu edhe kundër imperializmit italian dhe kontrarevolucionit të brendshëm«.³⁷

Pas robërimit të ri të Kosovës, më vitin 1918, nga ana e borgezisë jugosllave, në Kosovë u zhvillua një lëvizje nacionale e fuqishme. Nën presionin e kësaj lëvizjeje, qeveria borgeze e Shqipërisë në krye me Turhan Pashën kërkoi prej Lidhjes së Kombeve që »në bazë të 14 pikave të Vilsonit t'i jepet pakicës nacionale shqiptare në Jugosllavi e drejta e vetëvendosjes«. Por, Lidhja e Kombeve nuk e pranoi këtë kërkesë në sajë të angazhimit të qeverisë jugosllave dhe të aleatëve të saj.³⁸

Pas Plenumit në Split më vitin 1935 dhe pas deklaratës së PKJ në Moskë më vitin 1936, Partia u angazhua që të realizohet parimi i vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar — sikurse edhe për popujt e tjerë të Jugosllavisë — me anë të zgjidhjes së çështjes nacionale në Jugosllavi në bazë federative. Duke dhënë inisiativë për rregullimin e ardhshëm federativ, me formimin e udhëheqjeve autonome partiake sipas kombeve, Partia vendosi më vitin 1937 që të formojë komitete qendrore të Partisë Komuniste për Slloveni dhe për Kroaci dhe Komitetin Krahinor të PKJ për Kosovë e Metohi, i cili në atë kohë ishte i lidhur drejtpërdrejt me Komitetin Provincial të PK për Mal të Zi, Bokë e Sanxhak.³⁹

Mirëpo, kur shokët Milladin Popoviq dhe Boro Vukmirovicq parashtruan në Konferencën e Pestë të PKJ në Zagreb, më vitin 1940, çështjen delikate nacionale të shqiptarëve dhe strukturën e popullsisë së Kosovës e të Metohisë, ata theksuan njëkohësisht edhe nevojën e autonomisë më të madhe të Komitetit Krahinor të Partisë për Kosovë e Metohi dhe lidhjes së tij me Komitetin Qendror të PKJ. Lidhja e këtillë e drejtpërdrejtë e Komitetit Krahinor vazhdoi gjer më vitin 1945.

Çështja e vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi ka qenë e pranishme shumë herë, sidomos gjatë revolucionit socialist. Dëshirojmë të theksojmë se gjatë LNC shqiptarët kanë pasur tretman të njëjtë në çdo pikëpamje, e edhe sa i përket së

³⁶ *Ibid*, faqe 163.

³⁷ *Ibid*, faqe 145.

³⁸ Z h i v k o A v r a m o v s k i, *Kopja e veçantë*, »Gjurmimet albanologjike« Nr. 2, Prishtinë 1965, faqe 230.

³⁹ L l a s l l o R e h a k, *ibid*, faqe 301.

drejtës për vetëvendosje, sikur të gjithë popujt e tjerë të Jugosllavisë, gjë që shihet prej dokumentave të shumtë partiakë.⁴⁰

Kështu, në një ndër proklamatat e para të Komitetit Krahinor të PKJ për Kosovë e Metohi, në maj të vitit 1942, vihet në dukje thelbi i vetëvendosjes së popullit shqiptar me këto fjalë: »Fati i çdo populli, e madje edhe i atij më të vogël, sot është në duar të tij. Sot ka ardhur çasti që të çlirohemi një herë e përgjithmonë« edhe ju, shqiptarët.⁴¹ Në një proklamata tjetër të këtij forumi vihet në dukje perspektiva e Jugosllavisë së re, e cila duhet të sigurojë barabarësi të plotë nacionale, kështu që në të thuhet:

»PKJ nuk e njeh copëtimin e Jugosllavisë; ajo është për vetëvendosjen revolucionare të popujve . . . Luftën në Jugosllavi e udhëheq PKJ, e kjo luftë ka për t'i sjellë liri popullit shqiptar. Kur të dëbohet pushtuesi dhe të likuidohen bashkëpunëtorët e tij, para të gjithë popujve të Jugosllavisë do të shtrohet çështja e rregullimit të jetës së tyre ashtu si duan ata vetë«. Qëndrimi i këtillë u muar në frymën e letrës direktive të KQ të PKJ dërguar Komitetit Krahinor të Partisë, ku thuhet: »Formoni frontin unik antifashist të të gjithë popujve të Kosovës e të Metohisë në bazë të luftës kundër pushtuesit dhe në bazë të vetëvendosjes së popujve pas çlirimit«. ⁴²

Gjithashtu, në një proklamata të Komitetit Krahinor të Partisë për Kosovë e Metohi, në shkurt të vitit 1943, flitet për të drejtën e vetëvendosjes së popullit shqiptar në Jugosllavi dhe thuhet: »Pas disfatës së fashizmit, të gjithë popujt do të fitojnë të drejtë të vendosin vetë për fatin e tyre, pa u përzier të tjerët«. ⁴³

Një afirmim i rëndësishëm i konceptit të vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar është shprehur në Rezolutën e Këshillimit të Komitetit Krahinor të PKJ për Kosovë e Metohi në Sharr, në shtator të vitit 1943. Në këtë dokument insistohet për të drejtën e vetëvendosjes së popullit shqiptar dhe thuhet: »Me luftë të popujve të Jugosllavisë janë siguruar kushtet për realizimin e lirisë, pavarësisë dhe të drejtës së vetëvendosjes së të gjithë popujve të Jugosllavisë«, e prandaj edhe juve, shqiptarëve.⁴⁴ Rezoluta i lidh të drejtat për vetëvendosje të popujve të Ballkanit me formimin e Shtabit Ballkanik të LNÇ dhe AP dhe me federatën e ardhshme ballkanike.⁴⁵ Për ta sanksionuar edhe juridikisht të drejtën për vetëvendosje të popujve të Kosovës, Rezoluta shtron detyrë që të pregatitet Konferenca e parë e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e Metohisë, ku do të proklamohet kjo e drejtë dhe do të vihen themelet e autonomisë së Kosovës në Federatën jugosllave.⁴⁶

⁴⁰ Hajredin Hoxha, *Rëndësia e amandamenteve kushtetuese për afirmimin e kombësisë shqiptare në Jugosllavi*, »Përparimi« Nr. 4, 1971, Prishtinë, faqe 271.

⁴¹ *Zbornik dokumenata i podataka o Narodnooslobodilačkoj borbi naroda Jugoslavije*, tom I, *Borbe na Kosovu 1941-1944*, Beograd 1969, faqe 86.

⁴² *Ibid.*, faqe 189-190 dhe si shën. 30, faqe 114.

⁴³ *Ibid.*, faqe 201.

⁴⁴ *Ibid.*, faqe 314.

⁴⁵ *Ibid.*

⁴⁶ *Ibid.*

Duke i popullarizuar qëndrimet e PKJ, vendimet e Këshillimit në Sharr etj., komandanti i Shtabit Kryesor të UNÇ dhe APJ për Kosovë e Metohi, Fadil Hoxha — në një artikull më vitin 1943 — ka shkruar sa vijon: »Popujt e Kosovës dhe të Metohisë do ta mbajnë konferencën e tyre të Këshillit Nacionalçlirimtar, ku do të zgjedhet Këshilli Krahinor Nacionalçlirimtar. Kjo do të jetë konferencë, e cila do të na sigurojë lirinë dhe autonominë e plotë nacionale.«⁴⁷

Si shihet në dokumentat e përmendur, gjatë revolucionit është theksuar shpesh parimi i vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar, por nuk është caktuar konkretisht se me çfarë modalitete dhe si do të realizohet kjo në mënyrë konkrete, gjë që ka krijuar disa dilema dhe probleme në lidhje me tubimin e masave shqiptare në LNÇ. Këtë problem e parashtroi në Komitetin Qendror të PKJ Milladin Popoviq, në një letër në të cilën thuhet: »Ne e kemi theksuar gjithnjë parullën e vetëvendosjes nesër. Në këtë mënyrë nuk ka mundur të mobilizohet populli shqiptar kundër pushtuesit, »çlirimtarit«. Në këtë letër kërkohet që KQ i PKJ të marrë qëndrim konkret dhe të caktojë solucionin e vetëvendosjes së shqiptarëve në Jugosllavi, duke marrë eventalisht qëndrim të njëjtë sikurse edhe për vetëvendosjen e pakicës nacionale sllovene dhe maqedone në vendet fqinje.«⁴⁸

Individët dhe organizatat e forumet partiake në teren e theksonin nëvojën e konkretizimit të qëndrimeve për vetëvendosjen e nacionalitetit shqiptar. Kështu, Komiteti i PKJ i rrethit të Prizrenit — në një letër dërguar Komitetit Krahinor të Partisë — vë në dukje se simpatizuesit e LNÇ nuk e kuptojnë çështjen e vetëvendosjes ashtu si e shpjegojnë ata dhe thuhet: »Ne u flasim se vetë populli do të vendosë për fatin e vet, por atyre u duket e çuditshme kjo përgjigje, sepse kërkojnë që t'u thuhet se a do t'i bashkohet Kosova Shqipërisë në periodën e pasluftës.«⁴⁹

Duhet theksuar këtu se orientimet nga konkretizimi i solucionit të realizimit të parimit të vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi janë krijuar në lidhje me idetë e PKJ për formimin e konfederatës ballkanike pas çlirimit të popujve të Ballkanit, me çka do të krijoheshin kushte për unjësimin e popujve të copëtuar të Ballkanit.

Në vijë të këtyre ideve, si duket i paautorizuar konkretisht, Svetozar Vukmanoviq ndërmerre masa konkrete, kështu që pas vizitës së tij në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri u zhvilluan biseda për formimin e Shtabit Ballkanik. Lidhur me këtë, Vukmanoviq e informonte Titon »se në mbledhje të përfaqësuesve të PK të Jugosllavisë, Greqisë, Shqipërisë dhe Bullgarisë është arritur marrëveshja për formimin e Shtabit Ballkanik, në të cilin kishin për të hyrë përfaqësuesit më eminent të LNÇ të vendeve ballkanike dhe i cili

⁴⁷ *Ibid*, faqe 299.

⁴⁸ Letra e Milladin Popoviqit, dërguar Komitetit Qendror të PKJ, Arkivi i Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, dokumenti Nr. 181.

⁴⁹ Si shën. 41, faqe 368.

kishte për të pasur në krye katër komandantë.⁵⁰ Në letër thuhet se madje është caktuar edhe data e fillimit të veprimit të këtij Shtabi.⁵¹

Svetozar Vukmanoviq i dha orientim të këtyllë edhe Komitetit Krahinor të Partisë, i cili — në Rezolutën e Këshillimit krahinor në Sharr — theksoi si një ndër parullat edhe popullarizimin e Shtabit Ballkanik.

Në kohën e popullarizimit të Shtabit Ballkanik, kur nuk ishin eliminuar dilemat në lidhje me solucionin e realizimit të parimit të vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi, fill pas mbledhjes së dytë të AVNOJ-it, nga fundi i vitit 1943, filloi seanca e Konferencës së parë të Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar, ku u muar qëndrimi edhe rreth çështjes së vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar.

Pasi vlerësoi zhvillimin e LNÇ në Kosovë, insistoi për nevojën e luftës së përbashkët të të gjithë popujve dhe për vëllazërimin dhe bashkimin e tyre, Rezoluta caktoi sa vijon në lidhje me parimin e vetëvendosjes: »Kosova e Metohia është regjion, në të cilin jeton në pjesën më të madhe populli shqiptar, i cili — si gjithmonë, ashtu edhe sot — dëshiron të bashkohet me Shqipërinë. Prandaj, ndiejmë për detyrë të vemë në dukje rrugën e drejtë, të cilën duhet ta ndjekë populli shqiptar, që shqiptarët e Kosovës dhe të Metohisë të bashkohen me Shqipërinë — kjo është lufta e përbashkët, me popujt e tjerë të Jugosllavisë, kundër pushtuesit dhe bashkëpunëtorëve të tij të vendit, sepse kjo është e vetmja rrugë që të fitohet liria, kur të gjithë popujt — e prandaj edhe shqiptarët — do të shprehen për fatin e tyre, me të drejtë të vetëvendosjes gjer në shkëputje. Garanci për të gjitha këto janë UNÇ e Jugosllavisë dhe UNÇ e Shqipërisë, me të cilën është e lidhur ngusht. Përveç kësaj, janë garanci aleatët tanë të mëdhenj: Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe dhe Amerika (Karta e Atlantikut dhe Konferenca e Teheranit)«.⁵²

Sipas mendimit tonë, qëndrimi më i rëndësishëm në Rezolutë — për saksionimin juridiko-politik të së drejtës për vetëvendosje të nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi — është ky: »sepse, kjo është e vetmja rrugë që të fitohet liria, kur të gjithë popujt, e prandaj edhe shqiptarët, do të shprehen për fatin e tyre, me të drejtë për vetëvendosje gjer në shkëputje«.⁵³ Jemi të mendimit se po të insistonte Rezoluta në këtë qëndrim, nuk do të shkaktonte disa dilema, që kanë krijuar në radhët e fuqive burokratike dhe unitariste mosbesim ndaj nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi.

Shoku Tito e kritikoi konkretizimin e së drejtës për vetëvendosje të shqiptarëve në momentin përkatës me anë të solucionit të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Në lidhje me këtë, në një le-

⁵⁰ Letra e Svetozar Vukmanoviqit — Tempos, dërguar shokut Tito, dok. 19-62, V, 1-42 (43), Instituti për lëvizjen ndërkombëtare punëtore, Beograd.

⁵¹ Ibid.

⁵² Këshilli Nacionalçlirimtar i Kosovës dhe i Metohisë 1943-1953, Prishtinë 1953, faqe 45.

⁵³ Letra e shokut Tito, dërguar Svetozar Vukmanoviqit më vitin 1943, dok. nr. 1976-I-3-43, Instituti për lëvizjen ndërkombëtare punëtore në Beograd.

tër dërguar Komitetit Krahinor të Partisë ai ka shkruar: »Sot, shokë, nuk është fjala për caktimin e kufinjve në mes të Shqipërisë dhe Jugosllavisë, të dy vende të pushtuara, por për çlirimin e tyre me luftë të armatosur. Për këtë arsëye, çdo caktim i kufinjve, në të vërtetë, u ndihmon gjermanëve që t'i nxisin popujt njërin kundër tjetrit. Pastaj, duhet përfillur faktin se lëvizja nacionalçlirimtare sot është më e forta në Jugosllavi dhe se popujt e vegjël fqinj (për shembull, shqiptarët) mund të çlirohen relativisht lehtë duke u mbështetur në popujt e Jugosllavisë, në vëllazërim me ta, të cilët nga ana e tyre nuk do t'i shtypin popujt e tjerë, as nuk do t'i pushtojnë territoret e tyre. Pra, sot do të ishte krejt gabim të parashtrihen dhe të zgjidhen çfarëdo çështje kontestuese. Këto mund të zgjidhen në mënyrë të drejtë vetëm nga ana e popujve të lirë.«⁵⁴

Në këtë frymë, shoku Tito u dërgoi letra edhe KQ të PK të Shqipërisë, Milladin Popoviçit dhe Svetozar Vukmanoviçit. Pas marrjes së këtyre letrave dhe pas informimit për qëndrimet e shokut Tito, me këto qëndrime u solidarizuan Komiteti Krahinor i PKJ për Kosovë e Metohi, KQ i PK të Shqipërisë dhe Milladin Popoviç. Në këtë pikëpamje, sekretari i KQ të PK të Shqipërisë, Enver Hoxha, i dërgoi Komitetit Krahinor të PKJ për Kosovë e Metohi, në prill të vitit 1944, një letër në të cilën thuhet: »Duhet bërë çmos që vëllazërimi i popujve të Jugosllavisë... dhe të ruheni prej crackave, të cilat do të ju bëjnë gjithnjë shovenistët, duke i nxitur popujt nga grindjet reciproke«. Në të njëjtën frymë është edhe letra e Milladin Popoviçit, dërguar Komitetit Krahinor të PKJ për Kosovë e Metohi, ku ai solidarizohet me qëndrimet e shokut Tito në lidhje me ardhmërinë e Kosovës.^{54/a}

Shoku Tito është angazhuar kategorikisht për të drejtën e vetëvendosjes së Kosovës dhe të nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi, gjë që është shprehur në mënyrë të qartë në disa paraqitje të tij. Kjo është shprehur plotësisht edhe në një letër, dërguar Svetozar Vukmanoviçit me rastin e disa tendencave separatiste në KQ të PK të Maqedonisë. Në këtë letër, shoku Tito e lidh çështjen e vetëvendosjes së Maqedonisë dhe të Kosovës dhe thotë: »Populli maqedon ka të drejtë të vetëvendosë, e madje edhe të shkëputet... por, populli maqedon, sovran në të drejtat e veta, ka të drejtë edhe të bashkohet në bashkësinë federative të popujve të tjerë; sot ai duhet të veprojë kështu dhe t'i bashkohet luftës së përbashkët të popujve të tjerë kundër pushtuesve gjermanë dhe bullgarë, sepse kjo është e vetmja garanci e lirisë së popullit maqedon«. Duke mos i përsëritur të njëjtat fjalë për çështjen e vetëvendosjes së Kosovës, por duke i nënkuptuar, shoku Tito ka shkruar: »Në mënyrë të ngjashme duhet të parashtrihet çështja e Kosovës dhe e Metohisë.«⁵⁵

⁵⁴ Letra e J. B. Titos, dërguar Komitetit Krahinor të PKJ për Kosovë e Metohi, dok. nr. 1. b. 4812... 16/32, Instituti për lëvizjen ndërkombëtare punëtore në Beograd.

^{54/a} Si shën. 41, faqe 505 (Letra e Enver Hoxhës, dërguar Komitetit Krahinor të PKJ për Kosovë e Metohi), Letra e Milladin Popoviçit, dërguar Komitetit Krahinor të PKJ për Kosovë e Metohi, dok. 183, Arkivi historik i Komitetit Krahinor të LK të Kosovës.

⁵⁵ Si shën. 53.

Prandaj, shoku Tito e trajton në mënyrë të njëjtë çështjen e së drejtës për vetëvendosje të Kosovës dhe të Maqedonisë, si dhe çështjen e oportunitetit shoqëror të realizimit të kësaj të drejta me anë të shkëputjes. Me këtë rast, Tito ka pasur parasysh qëndrimin e cituar leninist, sipas të të cilit qëndrimi ndaj shkëputjes së kombit përkatës në momentin e caktuar duhet të merret nga aspekti i interesave të luftës klasore për socializëm. Në këtë pikëpamje, Tito ka konsideruar se akti i shkëputjes së Kosovës ose i Maqedonisë në momentin përkatës historik nuk kishte për ta ndihmuar, por për ta dobësuar luftën e popujve të Ballkanit kundër fashizmit.

Josip Broz Tito ka pasur gjithashtu qëndrim pricipialisht negativ në lidhje me çështjen e ndryshimit të kufinjve edhe kur ka qenë fjala për ndryshimin e kufinjve në të mirë të Jugosllavisë. Duke e informuar Dimitrovën për kontestin në mes të komunistëve maqedonë dhe atyre grekë rreth bashkimit të pakicës nacionale maqedone në Greqi me Maqedoninë, ai ka shkruar sa vijon: »Ne kemi bërë përpjekje t'i zgjidhim këto konteste, që komunistët maqedonë të mos e parashtrojnë tani çështjen e bashkimit të maqedonëve të Greqisë me Maqedoninë«.⁵⁶

Në këtë frymë, shoku Tito kritikoi edhe masat që ishin marrë për formimin e Shtabit Ballkanik. Në letër, dërguar Svetozar Vukmanoviçit, ai thotë: »Ti po sheh prej lajmeve të radios se tani janë duke u bërë në Angli dhe në Amerikë kombinacione me federata më të llojllojshme, të Evropës së Mesme, të Ballkanit etj. Të gjitha këto plane kanë për qëllim ta shfrytëzojnë zhvillimin jo të njëjtë të LNÇ në vendet e ndryshme, në të cilat ende nuk janë zhvilluar lëvizjet, si dhe t'i izolojnë prej Bashkimit Sovjetik«. Në këtë letër, Tito angazhohet për bashkëpunim të gjithanshëm dhe intensiv të LNÇ të popujve të Ballkanit.⁵⁷

Parashikimet e Titos për rrezikun e kompromiseve të fuqive të mëdha në dëm të popujve të Ballkanit u verifikuan në Jaltë, ku u bë ndarja e sferave të interesave në Ballkan në mes të fuqive të mëdha. Në këtë pikëpamje, »me rastin e takimit me 19 tetor, Çerçili i bëri Stalinit ofertën famoze, për ndarjen e sferave të interesave në mes të Bashkimit Sovjetik dhe Anglisë: Greqia 10:90, Romania 90:10, Bullgaria 75:25, Jugosllavia 50:50, kurse Stalini e parafoi këtë ofertë«.⁵⁸

Duhet theksuar se ky kompromis ka pasur pasoja tragjike për zhvillimin e LNÇ në Greqi. Sigurisht, pasoja të ngjashme do të mund të ishin edhe për popujt e tjerë të Ballkanit sikur LNÇ të mos ishte shumë e zhvilluar në Jugosllavi dhe në Shqipëri.

Prej konstatimeve të sipërme shihet se shoku Tito i ka kritikuar solucionet dhe modalitetet e ndryshme të realizimit të parimit të vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar në rrethanat përkatëse dhe në dimensionin përkatës të kohës, e jo kurrësi vetë parimin. Përkundrazi, në letrat e përmendura dhe në raste të tjera, sho-

⁵⁶ Letra e Titos, dërguar Georgi Dimitrovit, dok. nr. 21.697, Instituti për lëvizjen ndërkombëtare punëtoare në Beograd.

⁵⁷ Si shën. 53.

⁵⁸ »Politika«, 8 janar 1963.

ku Tito e ka përkrahur në mënyrë shumë kategorike vetëvendosjen e nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi dhe tretmanin e barabartë të Kosovës në kuadrin e federatës së ardhshme jugosllave. Kjo shihet edhe nga fakti se KQ i PKJ dhe Josip Broz Tito i kanë përmendur gjithnjë shqiptarët kur është folur për popujt e tjerë të Jugosllavisë dhe për të drejtën e tyre për vetëvendosje, si dhe e kanë apostrofuar Kosovën kur është folur për njësitë e tjera federale të vendit tonë.

Kështu, në një letër të KQ të PKJ dërguar Komitetit Krahinor të Partisë për Kosovë e Metohi, që erdhi pas marrjes së Rezolutës dhe të materialeve të tjera të Konferencës së parë të Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar të Kosovës e Metohisë, thuhet përveç të tjerash: »Mendojmë se, sa i përket vijës politike, të gjithë dokumentat janë me vend«. Duke i dhënë përkrahje të veçantë afirmimit të parimit të vetëvendosjes së shqiptarëve, në letër thuhet: »Së pari duhet t'i merrni e popullarizoni vendimet e AVNOJ-it. Ku qëndron thelbi i këtyre vendimeve? Në faktin se këto vendime u sigurojnë barabarësi të gjithë popujve të Jugosllavisë, se ato e bejnë të mundëshme të drejtën e vetëvendosjes... Duhet të bëhen përpjekje maksimale që t'u shpjegohet kjo gjë masave shqiptare.«⁵⁹

Shoku Tito e ka afirmuar qëndrimin për barabarësinë e nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi në artikullin e vet »Nacionalno pitanje u svjetlosti Narodnooslobodilačkog rata« (Çështja nacionale në dritën e Luftës Nacionalçlirimtare), i cili ka pasur gjatë luftës karakter programatik për caktimin e vijës së PKJ në lidhje me çështjen nacionale. Në këtë artikull, shoku Tito ka shkruar: »Fjala LNÇ kishte për të qenë vetëm një gënjeshtër, e madje edhe mashtrim, sikur përveç domethënjes jugosllave nuk do të kishte edhe domethënje nacionale, sikur përveç çlirimit të Jugosllavisë nuk do të ishte njëkohësisht edhe çlirim i kroatëve, sllovenëve, sërbëve, maqedonëve, malazezëve, shqiptarëve, muslimanëve etj., dmth. sikur LNÇ nuk do të kishte atë përmbajtje, sa që me të vërtetë t'u sjellë popujve të Jugosllavisë liri, barabarësi dhe unitet.«⁶⁰

Gjithashtu, shoku Tito e ka afirmuar parimin e vetëvendosjes së popujve të Kosovës në një artikull të vet tjetër, me këto fjalë: »Çështja e Maqedonisë, çështja e Kosovës dhe e Metohisë, çështja e Malit të Zi, çështja e Sërbisë, çështja e Kroacisë, çështja e Sllovenisë, çështja e Bosnës dhe e Hercegovinës — do të zgjidhet lehtë, me kënaqësi për të gjithë, vetëm në qoftë se e zgjidh vetë populli, e secili popull e fiton këtë të drejtë me pushkë në dorë në Luftën e sotshme Nacionalçlirimtare.«⁶¹

Theksuam kaq shumë fakte në lidhje me çështjen e vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptarë në Jugosllavi për shkak se para Plenumit të Brioneve kanë ekzistuar — e diku-diku ende kanë mbetur — pikëpamje, të cilat ia mohojnë nacionalitetit shqiptar në

⁵⁹ Letra e KQ të LKJ, dërguar Komitetit Krahinor të PKJ për Kosovë e Metohi, dok. nr. 48-12 (44), Instituti për lëvizjen ndërkombëtare punëtore në Beograd; si shën. 41, faqe 233 dhe Svetozar Vukmanoviç: *Revolucija koja teče*, Beograd, 1971, faqe 431.

⁶⁰ J. B. Tito, *Sabrana djela*, »Naprijed« Zagreb, lib. I, faqe 113.

⁶¹ J. B. Tito, *Nacionalno pitanje u svjetlosti Narodnooslobodilačke borbe*, artikull botuar në »Proleter« Nr. 16, më vitin 1942.

Jugosllavi të drejtën e vetëvendosjes. Duke vënë në dukje këtë problem, Milija Kovaçević e paraqiti — në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv të KQ të LK të Sërbisë dhe të Sekretariatit të Komitetit Krahinor të Kosovës, pas Plenumit të Brionëve — çështjen e nevojës së marrjes së qëndrimit të qartë lidhur me Rezolutën e Konferencës së parë të Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar të Kosovës e Metohisë, ku flitet për parimin e vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi.

Duke u përgjegjur në këtë çështje, kryesuesi i mbledhjes Dobrivoje Radosavleviq tha në mes të tjerash: »Lidhur me kufinj të, me vetëvendosjen — për çka foli shoku Milija — nuk është pa rëndësi t'i precizojmë qëndrimet në lidhje me këto çështje. Rreth kësaj janë zhvilluar diskutime, por nëse shikohet tani qëndrimi ynë në revolucion, vetëm ai është parimor dhe është me të vërtetë parimor, i përhershëm, pothua me afat të gjatë, në të vërtetë është e drejta për vetëvendosje gjer në shkëputje. Këtu nuk ka qëndrim tjetër. Këtë qëndrim në revolucion, kur shqiptarët na nevojiteshin për të marrë pjesë në LNÇ, ne e kemi theksuar mirë«, kështu që është e pamundur t'i mohohet kjo e drejtë ndonjë populli, e prandaj nuk mund t'i mohohet as nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi.⁶² Në këtë mënyrë, shoku Radosavleviq e afirmoi edhe një herë kategorikisht parimin e vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi.

Parimi i vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar dhe të popujve e kombësive të tjera të Kosovës është shprehur me rastin e konstituimit të autonomisë së Kosovës dhe kaktimit të statusit të saj në federatën jugosllave. Në të vërtetë, meqenëse pas Luftës së dytë botërore — për shkak të rrethanave ndërkombëtare dhe kundërshtimit të Stalinit — nuk u formua Konfederata Ballkanike, me të cilën është dashur të zgjidhet edhe çështja e unjësimit e popujve të copëtuar të Ballkanit, e prandaj edhe e popullit shqiptar, është parashtruar çështja e statusit të Kosovës në federatën jugosllave. Në lidhje me këtë, u paraqitën disa dilema:

Madje, u shpreh mendimi se përkohësisht, gjer sa të formohet konfederata ballkanike, kur Kosova do t'i bashkohej Shqipërisë, dmth. në ndërkohë Kosova duhet të ndahej në mes të tri republikave: Malit të Zi, Sërbisë dhe Maqedonisë. Mirëpo, këtë mendim e kundërshtuan energjikisht fuqitë progresive të Kosovës me anë të përfaqësuesve të tyre Milladin Popoviçit dhe Fadil Hoxhës në një mbledhje, që u mbajt në KQ të PKJ më vitin 1945. Këta shokë theksuan se autonomia e Kosovës e ka filluar qenjen e vet qysh me formimin e Komitetit Krahinor më vitin 1943, se ajo e ka pasuruar qenjen e vet autonome gjatë revolucionit socialist dhe se zgjidhja e propozuar është në kundërshtim me dëshirat dhe intere-

⁶² Shënimet stenografike nga mbledhja e Komitetit Ekzekutiv të KQ të LKS dhe të Sekretariatit të Komitetit Krahinor të LKS për Kosovë e Metohi në lidhje me zbatimin e vendimeve të mbledhjes së KQ të LKJ në Brionë më vitin 1966 dhe të mbledhjes VI të KQ të LKS, viti 1966.

sat e popujve të Kosovës. Pas konsultimit me shokun Tito, u vendos që Kosova të ketë status të autonomisë në kuadrin e federatës jugosllave.⁶³

Kur u vendos që Kosova të gëzojë status të autonomisë në federatën jugosllave, u çfaq një dilemë tjetër: cilës njësi federale t'i bashkohet ajo si njësi autonome, apo të inkorporohet drejtpërdrejt në Federatë. Meqenëse federata jugosllave shfrytëzonte përvojat e federatës sovjetike, ku të gjitha republikat autonome dhe provincat e krahinat autonome janë përfshirë në republika të ndryshme federale, duke mbetur njëkohësisht në lidhje të drejtëpërdrejtë me tërësinë me anë të përfaqësuesve në Sovjetin e Nacionaliteteve, u vendos që autonomia e Kosovës t'i bashkohet ndonjëres nga republikat fqinje dhe që, me anë të Dhomës së Kombeve, të inkorporohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë në Federatë.

Në bazë të marrëveshjes politike dhe në frymën e parimit të vetëvendosjes, është dashur që popujt e Kosovës të vendosin se cilës njësi federale do t'i bashkohet Kosova — Sërbisë, Maqedonisë apo Malit të Zi. Në procesin e diskutimit u shprehën disa mendime në lidhje me këtë çështje:

1. Ka pasur mendime se Kosova duhet t'i bashkohet Malit të Zi për shkak të traditës së mëparshme të lidhjes me Komitetin Provincial të Malit të Zi, Bokës dhe Sanxhakut në periodën prej vitit 1937 gjer në vitin 1940, si dhe për shkak të mentalitetit të ngjashëm të popullit shqiptar dhe atij malazez.

2. Kanë ekzistuar mendime për bashkimin e Kosovës me Maqedoninë, me arësyetim se populli shqiptar dhe ai maqedon janë të ngjashëm për nga numri, se kanë pasur fat të ngjashëm në të kaluarën dhe se ekziston lidhmëria ekonomike e Kosovës me Maqedoninë.

3. Mirëpo, pas shkëmbimit të mendimeve, prapëseprapë domi-noi bindja se Kosova duhet t'i bashkohet Republikës së Sërbisë. Për një vendim të këtillë u vunë në dukje këto argumente:

— një ndër arësyet qenësore ishte e lidhur me faktin se në Kosovë jetojnë më se 20% të popullsisë së nacionalitetit serb, e cila — gjë që është e natyrshme — synonte të jetë në kuadrin e Republikës së Sërbisë;

— meqenëse njësia tjetër autonome në Jugosllavi, Vojvodina, duhet t'i takonte normalisht Sërbisë për shkak të përbërjes nacionale, u konsiderua e dobishme që të dy autonomitë të jenë në kuadrin e një njësie federale, me qëllim që problemet e tyre specifike të zgjidhen në kuadrin e kësaj republike;

— për bashkimin e Kosovës me Republikën Federale të Sërbisë u përmend si arësye edhe fakti se kjo Krahinë është më e pazhvilluarja në Jugosllavi, se Sërbia është njësia federale më e ma-

⁶³ Hajredin Hoxha, *ibid*, faqe 274.

dhe në Jugosllavi, kështu që do të mund të japë ndihmë të rëndësishme ekonomike për zhvillim të shpejtuar të Kosovës, krahas me ndihmën që do t'i jepet kësaj Krahine nga ana e Federatës;

— gjithashtu, një ndër motivet e internacionalistëve dhe komunistëve të nacionalitetit shqiptar dhe të atij sërë për bashkim me Sërbinë Federale është i lidhur me nevojën që, me anë të jetës së përbashkët, të afrohen populli shqiptar dhe ai sërë, të cilët në të kaluarën — për shkak të politikës së qarqeve sunduese — kanë vepruar njëri kundër tjetrit. Konsiderohej se jeta e përbashkët dhe interesat e përbashkëta kanë për t'i eliminuar antagonizmat e mëparshme dhe për të krijuar kushte për barabarësi të plotë, vëllazërim e bashkim të popullit shqiptar dhe atij sërë. Nga ana tjetër, bashkimi me Sërbinë Federale ka qenë, gjer-diku, edhe kompromis ndaj paragjyqimeve të vjetra për Kosovën Sërbe, me të cilat kanë qenë të ngarkuar jo vetëm disa shtresa sociale të Sërbisë, por edhe një numër komunistësh dhe njerëzish udhëheqës të kësaj njësie federale.

Në bazë të këtij orientimi, në sesionin e dytë të Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar u aprovua vendimi që Kosova t'i bashkohet Sërbisë Federale dhe Jugosllavisë Demokratike Federative. Në këtë vendim thuhet: »Populli i kësaj Krahine është i bindur se gëzon përkrahje të plotë në pushtetin popullor të Sërbisë, e se prej pushtetit popullor të mbarë Jugosllavisë do të ketë ndihmë të gjithanshme për ngritjen e vet politike, nacionale, ekonomike dhe kulturore, kurse përfaqësuesit e Krahinës në Kuvendin Popullor të Sërbisë dhe në AVNOJ do t'i japin kontribut me të gjitha fuqitë e veta ndërtimit të Jugosllavisë së lirë Demokratike Federative.«⁶⁴

Prandaj, vendimi për statusin e Kosovës si autonomi ka pasur karakter të dyfishtë: ai ka shënuar bashkimin me Sërbinë Federale, por njëkohësisht inkorporimin e Kosovës në Jugosllavi si element i saj konstituitiv. Pikërisht dokumenti i përmendur flet për këtë karakter të dyfishtë. Mirëpo, në kompleksin e kësaj, prapëseprapë elementi federativ i autonomisë së Kosovës ka qenë më i theksuar, çka shihet edhe prej procedurës së marrjes së vendimit për statusin e autonomive në Jugosllavi. Në të vërtetë, vendimi i mbledhjes së dytë të AVNOJ-it së pari u muar në shqyrtim në mbledhjen e tretë të AVNOJ-it, ku u aprovua qëndrimi që Kosova, si njësi autonome, të jetë element konstituitiv i Federatës Jugosllave dhe t'i bashkohet Sërbisë Federale.⁶⁵ Vetëm pas vendimit të Kuvendit të Kosovës dhe të Mbledhjes së tretë të AVNOJ-it, Kryesia e AVNOJ-it aprovoi Ligjin për njësitë autonome në kuadrin e Sërbisë Federale.⁶⁶

Prandaj, formimi i autonomisë së Kosovës dhe caktimi i statusit dhe ardhmërisë së saj në kuadrin e federatës jugosllave dhe Re-

⁶⁴ Këshilli Nacionalçlirimtar i Kosovës e i Metohisë 1943-1953, Prishtinë, 1953, faqe 45.

⁶⁵ Llasilo Rehak, *ibid*, faqe 337 dhe Stanoje Aksiq, *ibid*, faqe 140.

⁶⁶ Zakon o ustanovljenju i ustrojstvu Kosovsko-Metohijske Oblasti, neni 2, »Fletorja zyrtare e Sërbisë« Nr. 28, datë 8 shtator 1945.

publikës së Sërbisë është realizuar në bazë të vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi, respektivisht vetëvendosjes së të gjithë popujve të Kosovës.

Jemi të mendimit se parimi i vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi është përfshirë në mënyrë implicite në shumë dokumenta politikë dhe juridikë: në Programin e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë i vitit 1958, në Kushtetutën e vitit 1963 dhe në amandamentet kushtetuese të viteve 1968 e 1971, si dhe në Kushtetutën e RS të Sërbisë dhe në Ligjin Kushtetues të Krahinës së Kosovës.

Sipas mendimit tonë, parimi i vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar është përfshirë në qëndrimin e Kushtetutës federative së Jugosllavia është »republikë federative e popujve dhe kombësive të lira dhe të barabarta«,⁶⁷ pastaj në amandamentin XIX se »e para, në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë popujt dhe kombësitë janë të barabartë«⁶⁸ dhe në amandamentin kushtetues XX, ku thuhet: »1. Njerëzit punues, popujt dhe kombësitë i realizojnë të drejtat sovrane në republikat socialiste dhe në krahinat socialiste autonome, në pajtim me të drejtat e tyre kushtetuese, kurse në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë kur kjo është në interes të përbashkët«. Ky amandament e cakton edhe rolin e republikave socialiste, krahinave autonome dhe komunave në afirmimin e sovranitetit të popujve dhe të kombësive, me çka afirmohet edhe parimi i vetëvendosjes.⁶⁹

Të gjitha qëndrimet e përmendura parimore janë përfshirë edhe në kushtetutat e republikave dhe në ligjet kushtetuese të krahinave autonome.

Parimi i vetëvendosjes është afirmuar në mënyrë të fuqishme në pavarësinë e republikave dhe të krahinave autonome me anë të parimit të marrëveshjes dhe pajtimit të obligueshëm të të gjitha republikave dhe krahinave autonome për ndryshimin e Kushtetutës dhe për marrjen e vendimeve më të rëndësishme në kuadrin e kompetencave të Federatës (amandamentet XXXII e XXXIII).

Parimi i vetëvendosjes është sanksionuar, sipas mendimit tonë, edhe në Ligjin Kushtetues të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, ku konstatohet gjeneza e formimit të Krahinës, kështu që thuhet: »Krahina Socialiste Autonome e Kosovës është formuar në luftë të përbashkët të popujve dhe të kombësive të Jugosllavisë në LNÇ dhe në revolucion socialist dhe, në bazë të dëshirës së shprehur lirisht të popullsisë — popujve dhe kombësive të Kosovës: shqiptarëve, sërbeve, turqve, malazezëve e të tjerëve dhe në bazë të dëshirës së shprehur lirisht të Sërbisë Federale — iu bashkua Republikës Socialiste të Sërbisë në kuadrin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë«.⁷⁰ Prandaj, formimi i KSA të Kosovës dhe statusi i saj në RS të Sërbisë dhe në RSFJ është caktuar në bazë të dëshirës së lirë edhe të nacionalitetit shqiptar në

⁶⁷ Kushtetuta e RSFJ, Zagreb 1969, faqe 3.

⁶⁸ Ibid, faqe 134.

⁶⁹ Amandamenti XX në Kushtetutën e Federatës.

⁷⁰ Ligji Kushtetues i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1969, faqe 7.

Jugosllavi, me çka shprehet parimi i vetëvendosjes së këtij nacionaliteti, sepse dëshira e lirë e popullit është atribut qenësor i parimit të vetëvendosjes. Mendimin e këtillë e ka mbrojtur edhe Stanoje Aksiq në tezën e tij të doktoranturës, duke theksuar se autonomia e Kosovës është formuar në bazë të vetëvendosjes së popujve të Kosovës.⁷¹

Përfundimi

Tërë parashtrimi në lidhje me procesin e vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi tregon se parimi i vetëvendosjes është realizuar nëpërmes të tërë jetës revolucionare dhe lëvizjes nacionale të nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi, e sidomos gjatë revolucionit socialist dhe me formimin e bashkësisë federative të Jugosllavisë.

Në luftë për realizimin e së drejtës për vetëvendosje, nacionaliteti shqiptar ka gëzuar përkrahje të plotë dhe ndihmë nga ana e PKJ dhe të gjitha fuqive progresive të popujve dhe të kombësive të Jugosllavisë. Thelbi i së drejtës së vetëvendosjes së nacionalitetit shqiptar në Jugosllavi është përfshirë në dokumenta të shumtë politikë dhe juridikë gjatë revolucionit dhe në procesin e zhvillimit të pasluftës. Gjatë revolucionit socialist dhe në kohën e ndërtimit të socializmit, sidomos në periodën e zhvillimit të marrëdhënjëve vetëqeverisëse dhe federative, nacionaliteti shqiptarë e ka realizuar dhe e realizon parimin e vetëvendosjes me anë të aktivitetit shumë të fuqishëm kreativ të fuqive progresive në kuadrin e këtij nacionaliteti.

Dr Hajredin Hoxha

LE PROCESSUS DE L'AUTODETERMINATION DE LA NATIONALITE ALBANAISE PENDANT LA REVOLUTION ET L'EDIFICATION DU SOCIALISME

R é s u m é

Il est évident que, suivant le marxisme-léninisme, le principe fondamental de résolution de la question nationale est en effet le principe même de l'autodétermination des peuples. Dans ce sens, sur le plan théorique, il n'y a pas lieu de dilemme chez les théoriciens du marxisme. Cependant, chez les philosophes marxistes, ainsi que chez les autres, il existe un dilemme: le principe de l'autodétermination est-il valable pour les minorités nationales. Etant donné que la nationalité albanaise en Yougoslavie fait partie, de manière spécifique, des minorités nationales en général, et pour démontrer que dans celle-ci a existé le processus de l'autodétermination dans la Révolution so-

⁷¹ Stanoje Aksiq, referat me rastin e 20-vjetorit të formimit të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e të Metohisë, mbajtur në mbledhjen e përbashkët të të gjitha dhomave të Kuvendit Krahinor më 29 nëndor të vitit 1963, faqe 10.

cialiste, il est nécessaire de répondre en premier lieu, à la question suivante: le principe de l'autodétermination est-il valable aussi pour les minorités nationales?

Bien que Lénine n'ait nulle part traité, de manière explicite la question le principe de l'autodétermination est-il valable aussi pour les minorités nationales?, nous sommes d'avis que dans l'essence de la théorie de Lénine concernant la question nationale, de même que dans ses attitudes générales portant sur les questions concrètes des rapports entre les nations, on peut tirer la conclusion que Lénine sous-entend parfaitement que le principe de l'autodétermination est valable aussi pour les minorités nationales.

Tout ce qui est exposé sur le processus de l'autodétermination de la nationalité albanaise en Yougoslavie montre que le principe de l'autodétermination est réalisé à travers la vie révolutionnaire en entier aussi bien qu'à travers le Mouvement national de la nationalité albanaise en Yougoslavie et particulièrement pendant la Révolution socialiste et avec la constitution de la Communauté fédérative de Yougoslavie.

The first part of the paper discusses the importance of the research and the objectives of the study. It then describes the methodology used, including the data sources and the statistical techniques employed. The results of the study are presented in the following section, followed by a discussion of the implications and conclusions. The paper is organized as follows: Section 2 discusses the background and objectives of the study. Section 3 describes the methodology used. Section 4 presents the results of the study. Section 5 discusses the implications and conclusions. Section 6 provides a summary of the findings.

The study was conducted using a cross-sectional design. Data were collected from a representative sample of the population. The sample size was determined based on the desired level of precision and the variability of the variables being studied. The data were analyzed using descriptive statistics and inferential statistics, including regression analysis. The results show that there is a significant relationship between the variables of interest. The findings suggest that the variables are interrelated and that the model developed in the study is a good fit for the data. The implications of the study are discussed in detail, and it is concluded that the research has provided valuable insights into the topic.

The study has several limitations, including the cross-sectional design and the potential for common method variance. However, the findings are consistent with previous research and provide a solid foundation for further research in this area.

The authors would like to thank the following individuals for their assistance and support during the course of the study: [Name], [Name], and [Name].

Correspondence should be addressed to [Name], [Address], [City], [Country].

The authors declare that they have no competing interests. The data generated during the study are available upon request. The study was funded by [Funding Source].

This article is distributed under the terms of the Creative Commons Attribution License, which permits unrestricted use, distribution, and reproduction in any medium, provided the original author(s) and source are credited.

© 2010 [Author(s)]. This is an open access article distributed under the terms of the Creative Commons Attribution License, which permits unrestricted use, distribution, and reproduction in any medium, provided the original author(s) and source are credited.

Received: [Date] Accepted: [Date] Published: [Date]